

PAPÀS VINCENZO SELVAGGI

Lutje

(Preghiere)

Hyljndēses

Lutje

O Ynzot,
na ke lënë vetmíth
të ngasmi tek udha
me kultimet,
tërbimet
dhë mushaverét tanë.

Shkoi moti
dhë duart janë akoma të shtërnguar,
t'armatur kundër fytyra të pa-njohura.
Na ke lënë vet
tue lipisur fjalë e bukë
mbi diert e qetme të motit,
tue trashiguar gjellën tonë
mbi shurazit
tek më shtërpohet dejtí.

Shkoi moti e vate
dhë vëdës paravera
mbi këmbezit të shtrëmbura
të lulevet e thajtura.
Ku qelñjën lumet e tua, o Zot?
Na ke lënë vet
të mbaronjëm bukën tënde
të fëshehur te hjea muravet
në ditë plot diell i llambaristë.

Shkoi moti
dhë pritja zgarrixjàsi duart...
ku qelñjën rugat e tua, o Zot?
Mirr vesh lutjen tonë.
Qindrò me ne, o Zot,
dhë ndihna neve të gjëmi shëndete
të pastrohemi tek mé e madhja katharsi
dhë kështù të kemi, të gëzuer,
të perjetëshem pasuri.

Shëmërisë Mjesmbjelljes a e Kostantinopullit

Mori Zonja Shën Mëri,
të dua mirë si syt'e mi,
për jëm e dashur në dhé
Tyj ç'jé plot me hir'a hjé.
Ki për mua lipisi,
ëm shëndetë edhè fuqi.
Vrej lavomat e ksaj gjellë
Rueji mirë sa më hyjtin thellë!
Por sa janë lulet e vjollat,
cë ndë Maj Tyj mes-hollat
sjellën të të bëjen nderë,
aq janë hiret, çë nga herë,
Ti më shprishen, zëmër gjerë.
Të ka hjé gjithë Tyj të t'thonë:
Ti e ke me Tyj t'Ën-Zon,
Ti e vetem je e pa-fëtesë
gjithë na vo e kemi besë;
porsi drita nga menatë
porsi mellodhi e gjatë,
gjella jote, Shëmëri,
ë si këndim a poesí!
Urë e shkallë, ç'lidhen qiellin
me kët dhé; t'mjesditës diellin
ti m'e shkon për bukurí
po më shumë për mirësi;
si ai jetën m'e dritson
gjellat tona na i liron!
Zonjë e mirë, e shumë hadhjare,
e rrethuar me vistare,
Ti çë gjalprin shkele e therte,
Lot' e Evës Ti ja terte.
Nì ç'te zëmra mbretëron
helmi i math, Ti mirrem vesh,

ni ç'therita mua m'kullon
shëromë andaj, Zonja Nojteshë.
Ti çë mbam mbë dor' at Djalë
liem lavomat me shumë val:
vrej rrëkimet, lotët çë mua
m' frushkullonjën më se krua.
Ndihamo, Hënëz, gjellën time
termë lot', mbjith kta shërtime.
Të ka hjé Tyj ditën sot
të t'bekonj Tyj nga dhivòt:
qofshë e lumtë me Zotin Krisht
dhè te gjuha jonë arbrisht!
Unë të falënj me hjidhi,
o Mjesmbjellje Shën Mëri.
Ti ç' Stambollin më na lé
për të vinje ktù me né;
male e pyle ti më shkove,
Dejtin Jon përfjutureve,
prindët me anitë ti i shpëtove.
Gjaku ynë pëstaj u shprish,
se nën turkun t'rrij ngë dish;
gjithsej buertim vet qëndroi
Besa jote çë na gëzoi.
Gjith'arbreshzit, Ti e di
par se t'stisjën të tyrët shpi
Tyj një qishë të lartësojen
e nga mot të madhojen!
Gjithë Katundzit arbreshë
Tyj t'kultojën Mbretëreshë:
Njo Spixana horë më e gjerë
të kremtòn tyjna me nderë!
Kremta jote bëhet me dritë
Ejaninë edhë Frasnitë.
Mbi malezit të lert' male
çë shkëlqejën borë e shi
ku pamja është më mirë
rruzullimi më i gjerë
atjë mbrënda nd'ato mjegulla
atjë Shëmëri ti rri,
Zonjë Hadhjare e bardhë si bora.

çë na sqepon tonat hora.
 Shoh po rehje gjelbullore
 plot katunde arbnore.
 Janë koce me ullinj fillarë
 çë pirgëzohen ture parë.
 Njota vreshtat të mira shumë
 ç'japën me verë një lumë.
 Vëndi i gjet shumë Shqipërisë;
 çon Parrajsin gjellërisë
 si ka dehti e ka Pre-Silla
 ku arbreshzit gjithë a filla,
 porsi nj' copë Shqipëri,
 çë Mbuzat njera Shën Sofi,
 stistin katundzit e qisht.
 Me zogjzit çë ktù fjasen arbrisht
 gratë tyj të nderojën
 dhë Kalimere të këndojën:
 « Nd'Eva guajet ti gëzim
 n'ajò mortë, ti gjellë na dhé...
 Si së njohe maj mbëkatën
 ka ajò neve ti llargona
 e nj'oqatë mbi neve shkona
 kur të vdesmi. O, sa fanmirë
 kush t'amàr me tèt Bir »!
 Kështù me hirë e me hajdhí
 të nderòn ajo Shën Sofi.
 Ësht Maqi ai katundjël
 me vreshta e voshqe i pështjël
 kremtën tënde bën e siell
 muzka të mira e shkreh' në qiell!
 Pas vjen Ungra me atë salinë
 çë Tyj t'e bën një fest'e finë
 Çifti mirë Tyj të kultòn
 Pllatani një javë më të nderòn.
 Pllatanjot' Arbreshvet të parë
 të ndërtuan një qishë të bukur
 tek lloku ë më i dukur
 pëstaj tëndin autàr
 e ngarkuan plot me àr.

Malezit si Anfiteatër i rrin
porsi luleza me vin.
Malin e dejtin ktù syu bashkòn
Ëmërin tënd gola këndon:
« Çë kur turku na u frugàr
Shëmmëria na dha rrëpar...
çë kur u nistim ka Shqipëria
neve na ndihu Shën Mëria;
Buartim gjithsej nd'atë Moré
po Shën Mërinë sualltim me né
Ruana mirë, Ti Shëmerí
me ato duar me ata sy...
me atà sy e me ato duar
puru ti më duke e helmuar;
helmi zëmrën më t'e preu
sa na pé të shperndàr te dheu.
Andàjna na ëmërin tënd
e shprishtim tek nga vënd... »
Anapul o ndë Siqellí
tek Apula o ndë Kallavri
qen arbreshzit çë sualltin
dhivoxjonën çë edhë lëtinjt muartin.
Lë Pulinin edhë prirem
njetër hëre ndë këmbt' e Silles
Shoh katunde të llarguar
ndëdenj sytë u ture shkuar;
ajirit i sulem si pëllumb i lerë
shkonj mbi ka do është fusha gjerë.
të paret rehje u fjuturonj
tek të tjeret më qëndronj.
Ktù, mori Zonja Shën Merí,
më shoh u tënden shtëpí.
Tek më i bukuri llok,
tek më hjeshmi sjét,
ka nj'anë malezit e Sillës
ka jetr'anë fushë dhè dét,
ktù sostin t'ecurit arbreshët
qishën tënde ndërtuan
dhè ngamòt të lavdëruan.
Ëmëri Vakaric vjen

Se Prëgjipi Bisinjanës
lopët e tyj bën e rrijen
Për ndét të Madhit Ushtërtor
çë i dha të vëj të mbesën kuror
Gjithë arbreshvet i dha rrëpar
dhera e kafsha i rrigallar'!
Kultohet se ahiera gratë arbresha
me stolitë si mbretëresha
me lesht' varra me haroma
e stolitë varra me ar
i nxuartin e t'i vun prëzë
Tyj Noiteshe, Tyj Lulerözë.
Dhë historia na e thot
sa për né bëre nga mot:
Ti Shëmëri gjithmon shpëtona
Porsi ahiera kur të bjerrë
ktena turku na vu guerrë
e ktjë posht ndë mes t'llakës,
ku janë guret a Buzçakës,
prindët e tanë e kumbistin
Konën tënde, Shëmëri,
rreth gurevet çë ng'i stistin,
e për një mërakulli
ushtërtorë guret m'u çuan
çë armikun më llarguan.
Sot si prrallëz është kultimi,
qindroi konza te Kamini.
Ndhna neve puru sot
e shëndetë ndëna ngamot;
ëmbelzona udhën e gjatë
e nga t'liqzit me atë shpatë
njerë kur na të gëzuer
e rrëmi te i sprasmi qitët:
Ti ç'jë një pa-mundur kullë
i munde e i bëre qullë
gjithë armiqzit barbarë
sa nga jotja shpatë qenë ngarë.
Porsa nën tënden hjen
vure të madhin Skanderbën
Shqiperia u mbjoth nën besën

ku odhë ni atrat na thrresën,
 se gjithë arbreshzit më parë
 ishën gjindë partikullarë!
 Njota qishën më e vanduar
 Vakariçjot' të ndërtuan.
 Kremten Tyj t'e bëjen Masarët
 me tumna grurë e vistaret;
 mbjdhëshin ng'atò visèle
 Konza jote i mbjith si dele.
 Pra kur gjithë më gjëndshin bashkë
 vijen e të çojen tyj mbë qishë,
 hyjen tue thënë Rruzarë.
 Ky ë zakoni ç'ish më parë,
 po jeta ni u shkatarrua
 traditat ranë te nj' prrua.
 U vrë moti shumë u nxí,
 natyra e vu një vell të zí.
 Kremten si t'e bënjen nj'herë
 ni mosnjë Tyj do t'e bënj
 ndë masàr dhë ndë bulerë
 se buertin besën edhë nderën
 zëmrën, e dl, janë t'e shqerën.
 Po ti Zonjë, Zonjë hadhjare
 njeter herë jipna rëpar:
 stolisna me tënden hirë
 mbi këtë dhé të bëmi mirë!
 Priri sytë të butë mbi né,
 vrej të ndajturit në dhé!
 Shprishe paqën e mirësinë
 e lirona nga kjò qinë!
 Zëmra janë çë t'e kan besë
 se ngamòt na ké kultesë;
 Bën të nëmurzit të kén
 rëpar nën tënden hié;
 Bën triesa t'i jet e shtruar
 fëmijt e tyre më të gëzuar,
 e i pasuri të më spëndonj
 atë çë i supërqòn,
 të kështët po gjithë të duhen
 si vëllezer edhë të shuhen

zjarrme, vole dhë rracisme.
Gjaku ynë shprishet angora,
lëjën dherat trimat tan,
ikjen ven te t'hjesmat hora
kush Torin e kush Milan.
Janë ata që ndrishe dhë
vanë të çojën gjellë të ré.
Tristimi më rrethoi katundin
në një vjersh as më njëkëndim
Shëmëri, thuam ç'ë kjo qinë?
Moti ç'ish më par u buar
Jeta, në krisë, ë e shkatarruar!
Thomse u serposë, dita
Botës zë e i shuhet drita?
Shpresa nga zëmrat u llargua
zakoni i mirë ra posht e u shua.
Po shoh se iken moti zi.
Ra shumë borë e ra shumë shi;
dhë njota dielli ture qeshur
trimat me besë i gjën të veshur
kur të dalt ai nga menatë;
Ai Diell jé Ti, e pa-mbëkatë,
çë na mbjove me të mirë
Ti, çë ndër gratë vet pate hirë
t'ishe e Jëmza t'Ynzoti,
çë pa i lindur te moti,
tek i bekuar tëndi gjí
u piks e u bë njeri:
Ti udhën neve dritsona
me faqën e Tyj njëditë gzona.

Doj të t'përpiqsha edhe unë
Mbi këtë kallvar çimendi
Çirinë llatje mbi rugat e rea
me asfalt, tue folur tue dëgjuar
tue thërritur asgjë gjëravet.
Qe njëndërr e fare më gjë!
Ç'është gjaku i shpërndarë?
Ç'është martiri të kërshterëvet?
Gratë qajnë akoma
mbi llavurinë e të bilvet.
Edhë unë të kriqsova
i shehur te ndonjë gonë ambnore
i lidhur, i mbajtur i ndëlier
nga gjinda pa-ëmer e tharosme.
Grua përsë qan?
Yt Bir përsëri lehet
tek yni djep.
Jam edhe u cë t'kriqsova
jam edhe unë çë t'kurorzova
Rregj i të përqeshurit
e i të absurdit
si njëistriën
të komedhjes së resë
tuke mbytur te fytyra
malin me të liga
çë më fëshehen gjalpri zî.
Gjithsëj qe njëndërr.
Ç'është mëkatja?
O Krisht, ëmer plot aml,
Gratë qajnë akoma
mbi fatkeqësinë e bilvet.
Grua, vre tët Bir!
Trim i kryqësuar
mbi një Kryqe të turpruar.
Dishërim i dëlirë
i mblatuar për gjithë jetënt

Perëndisë

At Fanmirë çë rri ndër qiell
çë bëre dhé, hënez e diell,
Ti çë gjithsej sheh e di,
kij për né shumë lipisi.
Ëm-na paqë, ëm-na shëndetë
sa të duhemi ndë ktë jetë.
Ëm-na mall ndë-na fuqi
mos bi t'bëmi na mëri!
Ndë kto ditë, çë kem t'rromi
ngasje e voll bi t'vinxhomi.
Ka do jemi djallthi i bjerr
na tandon ndër aq manër.
Po ti Tat ka na llargoje,
bekò neve, atë mallkoje.
Përherë, Zot, të parkalesmi
të lavdomi e të mallepsmi
me gjithë zëmër e ngullí
mbushur shpirtin me lligri!
Ngamòt tyj të zëmi fill,
për Tyj digjemi si kandill.
Ti je vërteta Ati ynë
çë kriarte gjithë këte qynë.
Shumë mirësi pate për né,
neve gjithë shorçit na dhé:
Na dhé duar, këmb e sy,
atë vet-henë plotë bukurí.
Me Tyj s'mund vëhet nj'i kështë
shumë fuqi Ti vet më ké.
Shum'i bukur jé ti At:
jé si dielli nga menatë.
Sembri na të mbami mbë zëmër,
se ti jé keq shumë i ëmbël;

na për Tyj jemi mbi dhé
i gjasmi tëndes vet-hé!
Na për Tyj s'kemi të pushuar
për ty vëdesmi tue kënduar.
Mall dhé fjamur yne i paré,
ç'u propre të m'arsoje dhén
për tët Bir, ç'qé lipisjaré
shpirtrat tanë në Parrajsit venë.
Furu kur jem' e vdesmi
na të thresmi e parkalesmi
me te zëmra një sperënxë
të shomi atë çë shpoi një llënxë,
të shomi Zonjen Shën Mëri
Me të bukurën shoqëri.

Fjalë të bjerrura

Janë të mbëllitura diert e rruzullimit
edhë fjalet zbardhullojen
àthun mbi muret e lara.
Hjë të zeza zgjaten mbrëmjes
mbi asfaltin e udhëvet
dhë mbë kotë presnë.
Krisje në ditën e kremtjes
nga tregjet të banuar me zëre
dhë mbë kotë drita
feksen mbi theroret:
Vdës mbi akullin e mermervet
martyri i Fjalës
dhë qetsia e vetme
mbleth lulet e jetës:
në të cila duar po fshehet
çmimi i Gjakut të pa-fajshëm?

Të Nëmurvjet

Llaudharmi t'Ënzot
se u hëngra sot
— Tha zonja Marie —
Menatë do të hashë ti,
i nëmur e i zi!
Po ai Zoti Krisht,
që mbjoi dejtin me pishq
dhë gjithë kët qinë mbi dhë
na dha neve të kështë,
të nëmurvjet më shumë
i dha t'ishen të lumë:
« Të parit kan jenë të prasmit
dhë të prasmit do të jenë të parit ».
Po zgjohi ju të varfër e ngini:
Ju çë nën qjirthetvet rrobnisë jini
nga haracet, nga kambet po dilni
kaptoni sheshe, pyle e te mali
më i lart e më i bukur ju mbjidhi
ku lehet dielli lirisë
dhë humbet hjea nëmurisë!
Liria të kështët lartëson
dhë jetën me paq më e mbjon.
SKANDERBEK, ti shpresa jon jé e qeve
kët dhurtí ndëjna ngamòt edhë neve.

Vëlla
ish akoma dritë
mbi theroret
dhë na nuk e dijëm.
Buhoi më bij
dal ka dal mbi arkatat
të mbushura me qetësi
si nj'i gjatë kombollua
kultimesh.
Fytyra turistit
ndan pa-prodhim
mermerin e shtyllavet.
O Ynzot,
ku do të vemi?
Jashta Tyj nuk ka paqë
as dashuri.
Ishëm vet
tue ngarë tek udha:
Qindrò me né, o Zot!
Kishem qëndruar vet
të kllisjëm duart
tek arët e qishëvet
dhë nuk e dijëm.....

Dielli në perëndim

Burim dritje i fshehur
te llavuria e revet
që zdrypet mbrëmanet
te hjea më e ndëndur
e kastjelvet kartje.
Dielli në perëndim,
zjarr i çelur
mbrëmanet ndër zëmrat.
Ësht akoma dritë ndër sy
akoma ét gjellëje.
Ësht akoma dritë në qiell
akoma dishërim i pa-masur.
Dielli në perëndim,
angim'i udhës
të mbrëmjes që vjen.
O e çmendshme pamjel
O lisù, drit'e pa-shùeshme
të lavdisò
të Atit edhè të Shpirtit Shejt:
Përatej të miriadhevet ylëz
që llambarisnjën ndër qiel
më jé Ti, o Zot,
lum dritje e fshehur.

Mori pa-kufirat e jetës
dhë shumë e vetëm shkretí
të jetëvet pa-tundur!
Ti o Ynzot, që nga gjithmon,
Për sa priren ditët,
jë i pari e i lurtmi,
mirr vesh lutjes tona,
Mos shko' po vre'
mbi lavomat tona,
dhë ndihna neve
me atë kryq druri;
ëmbelzona udhën e gjatë
ndë këtë dhé
njera kur edhe na të gëzuer
do të ngjitmi skallunet
e të prasmit qitët.